



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.97/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kualicionit Aleanca per Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), për shkak të vendosjes së posterit në objektin publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, Anr.97/2019 të datës 27.09.2017, ndërsa kualicionit Aleanca per Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 6.000 (gjashtëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me të cilën pretendon se me datën 26.09.2019, rreth orës 12:00, në Fushë Kosovë afër shkollës fillore “Mihail Grameno”, është parë i vendosur një poster i madh i kandidatit për kryeministër nga kualicioni AAK&PSD z.Ramush Haradinaj. Parashtruesi i ankesës me tutje thekson se vendosja e posterëve në afërsi të shkollave dhe institucioneve publike është e ndaluar me ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, perkatësisht nenin 33 pika b, me rregulloret 13/2013, neni 3 pika 3.4 dhe Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike neni 4 pika b, si provë për pretendimet e tyre paraqitësi ka bashkangjitur një (1) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 27.09.2019 kualicioni AAK&PSD, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se vendosja e posterit mbi rrugë publike të kandidatit për kryeministër z.Ramush Haradinaj është bërë nga ana e kompanisë SELMANS e kontraktuar nga ne, por me të pranuar njoftimin për ankesë kualicioni AAK&PSD ka kontaktuar strukturat menaxhuese të fushatës për të bërë heqjen e posterit. Kualicioni në fjalë në përgjigje në ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë provë e cila dëshmon heqjen e posterit, por vetëm fotografi nga publikimi në media i thirrjes së kualicionit AAK&PSD për respektimin rigoroz të rregullave zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për kryeministër nga kualicioni AAK&PSD z.Ramush Haradinaj, është ngjitur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e*

ndaluar nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit AAK&PSD, është shkëlur neni 33, pika b), të LZZP-së, pasi që posteri i kandidatit për kryeministër nga koalicioni AAK&PSD, është vendosur në objektin publik përkatësisht mbi rrugë publike. Të cilën shkëlje e ka pranuar edhe vetë koalicioni AAK&PSD, në përgjigjen në ankesë të datës 27.09.2019.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkëljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkëljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkëlje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, por zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se dy subjektet e koalicionit në fjalë, subjekti politikë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit të këtij koalicioni është vendosur në hapësirë mbi rrugë publike që nuk është vend i dedikuar për vendosjen e materialit propagonistik të zgjedhjeve gjatë fushatës zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZZAP-i e mori edhe faktin që koalicionit në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë dhe ta përmirëson shkëljen e bërë. Mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë shihet qartë se e kanë pranuar shkëljen dhe kanë deklaruar se e njejta është evituar, por nuk kanë ofruar asnjë dëshmi lidhur me atë se është bërë përmirësimi i shkëljes siç kërkohet me nenin 120 par. 1 pika a) të LZZP-së, të gjitha këto veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 97/2019 më datën 27.09.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi